



REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIC OF KOSOVO, REPUBLICA KOSOVARE, REPUBLICA KOSOVARE	
QEVERIA E KOSOVËS, VLADA KOSOVARE, GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGjisë DHE INOVACIONIT - MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTORI I ARKIVËS-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot.
Org. Imdhica	Bulet. Prot.
Org. Unit.	Prot. No.
Nr. i faqeve	Dati:
Br. stranica	Datum:
No. pages	Date:
Prishtina / a	

Nr. 01B / 488  
Datë: 21.11.2022

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja,**  
**Nauke, Tehnologije i Inovativnosti - Ministry of Education, Science, Technology and**  
**Innovation**

Nr. 01B / 488  
Datë: 21.11.2022

PËR: Sindikatën e Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës (SBASHK), përfaqësuar nga z.Rahman Jasharaj

NGA: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), përfaqësuar nga Ministrja znj.Nagavci

Data: 21 nëntor 2022

*Njoftim për shkëputje të Kontratës Kolektive të datës 22 janar 2021*

I nderuari z.Jasharaj,

Kontrata Kolektive e datës 22 janar 2021 e nënshkruar ndërmjet përfaqësuesve të SBASHK dhe MASHTI (këtu e tutje referuar si: Kontrata Kolektive apo Kontrata), përmes këtij Njoftimi për shkëputje të Kontratës Kolektive (këtu e tutje referuar si: Njoftimi) shkëputet njëanshëm nga ana e MASHTI, bazuar në kornizën ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, e për shkak të mungesës së bazës ligjore, shpërputhjes me dispozitat e rendit publik dhe mungesës së legitimitetit të palës nënshkruese.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka për qëllim vendosjen e ligjshmërisë. Mungesa e zbatimit të ligjit e me këtë, mbajtja në fuqi të kontratave që kundërshtojnë dispozitat ligjore, nuk prodhon rezultat të dobishëm për asnjëren palë. Përkundrazi, zbatimi i kontratës së paligjshme cenon përbushjen e të drejtave legitime të punëtorëve. Rrjedhimisht, MASHTI ka ndërmarrë këtë veprim, për t'i hapur rrugë negociimit të kontratës kolektive të ligjshme, që avancon dhe mbron të drejtat e punëtorëve të arsimit,

e që ngërthen në vetë përkrahjen ndaj punëtorëve të bazuar në nevojat dhe kushtet e punës.

Argumentimi ligjor i këtij veprimi është si më poshtë:

MASHTI, e përfaqsuar në kohën e nënshkrimit nga Ministri i Qeverisë në detyrë, ka pasë mungesë legjimitetit të hyrjes në politikë të këtillë disavjeçare. Neni 95 par.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (këtu e tutje referuar si: Kushtetuta) dhe nen 100 par.6 i Kushtetutës, në të dy rastet, qoftë atëherë kur Kryeministri jep dorëheqje apo posti i tij mbetet i lirë, qoftë atëherë kur ndaj Qeverisë në tërsi votohet mociioni i mosbesimit, Qeveria bie dhe konsiderohet "në detyrë". Në Vendimin KO72/20, Gjykata Kushtetuese potencon që: "*Legjimiteti demokratik i një Qeverie të zgjedhur nga një Kuvend i cili është i vetmi institucion i Republikës që zgjidhet drejtëpërdrejt nga populli, buron nga besimi që përfaqësuesit e popullit i mveshin me rastin e zgjedhjes së saj. Një Qeveri e zgjedhur nga Kuvendi, nuk vazhdon të ketë të njëtin legjitimet, nga momenti kur përfaqësuesit e popullit ia marrin besimin përmes votimit të një mociioni të suksesshëm të mosbesimit. Qeveria duhet gjithnjë të ketë të paktën besimin e shumicës së nevojshme në Kuvend. Ky besim pushon në momentin kur kundërt tij të kenë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht dhe bazuar në paragrafin 4 të nenit 100 të Kushtetutës, të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë. Me kalimin e micionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, kjo e fundit, humb besimin e përfaqësuesve të popullit, dhe rrjedhimisht edhe autoritetin kushtetues për të ushtruar kompetencat përkatëse. Prandaj, Kushtetuta përcakton që e njëjta është Qeveri në dorëheqje, sepse e humb mandatin qeverisës, ashtu siç, pa asnjë përjashtim të njëtin parim e përcaktojnë edhe të gjitha Kushtetutat e analizuara në Analizën Krahasimore dhe në të gjitha shtetet që kanë dhënë kontributin e tyre përmes Forumit të Komisionit të Venecias*". Në anën tjetër, në rastin KO95/20, Gjykata Kushtetuese thotë që: "*Për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, Gjykata thekson se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar "për" Qeverinë, gjegjësisht përvendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme*". Më tutje, Gjykata Kushtetuese përmbyll mendimin e saj në rastin KO95/20 duke thënë që: "*Gjykata e sheh të nevojshme që të sqarojë po ashtu se, duke u nisur nga parimi i sigurisë juridike, si dhe nga fakti se ky Aktgjykim nuk mund të ketë efekt prapaveprues, vendimet e Qeverisë aktuale mbeten në fuqi (duke iu referuar këtu vendimeve të Qeverisë Hoti), si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.*

Parografi paraprak e bën të qartë mungesën e kompetencës në marrjen e vendimeve në rast të micionit të mosbesimit edhe atij të shkaktuar nga mungesa e votave të duhura përvotimin e Qeverisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i vetmi institucion që zgjidhet drejtëpërdrejt nga populli. Përderisa, Qeveria Hoti ishte anti kushtetuese në thelbin e saj, vendimet e kësja të fundit, për shkak të mungesës së efektit prapaveprues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kanë mbetur në fuqi.

Megjithatë, Kontrata Kolektive është nënshkruar me datën 21 janar apo 30 ditë pas shpalljes së njoftimit nga Gjykata Kushtetuese lidhur me rastin KO95/20 dhe 26 ditë para mbajtjes se zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Kosovës. Qeveria Hoti, të cilës,

sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO72/20 i mungonte autoriteti kushtetutes për të ushtruar kompetencat përkatëse nuk ka pasur legitimitet për të qenë palë në procedurë e rrjedhimisht, as të nënshkruajë Kontratën Kolektive me SBASHK.

Më tutje, Kontrata Kolektive, sipas Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (këtu e tutje referuar si: Ligji i Punës), konkretisht nenit 4: "Dispozitat e Kontratës Kolektive, duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji". Pra, Kontrata Kolektive duhet domosdoshmërisht të jetë në pajtim me Ligjin e Punës. Kontrata aktuale në fuqi nuk i referohet fare Ligjit në Punës në preambulën e saj por i shmanget në tërësi, duke iu referuar vetëm Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore (këtu e tutje referuar si: Ligji për Administratën Shtetërore), i cili veçse ishte i shfuqizuar nga Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

Për më tepër, Kontrata Kolektive nuk është buxhetuar asnjëherë, nuk është nënshkruar nga ana e Ministrisë së Financave, përderisa e njëjtë parasheh obligime ne emër të Ministrisë së Financave e cila nuk është palë nënshkruese. Kështu, neni 45 i Kontratës Kolektive thotë që: "*MASHT, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të univiersiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësítë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023*". Nisur nga paragrafët e parë të këtij Njoftimi që dëshmojnë që në bazë të interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese Qeveria në detyrë nuk kishte kompetenca kushtetuese dhe ligjore të vepronë në drejtim të hartimit të politikave të reja e aq më pak, sipas analogjisë, të caktonte obligime për qeverinë në ardhje e pritshmërinë për palën tjetër kontraktuese pa pasë mundësi ndikimi në politikat shtetërore vijuese, e duke mos anashkaluar faktin që edhe në rastin e veprimit të ligjshëm të një qeverie sdo mund të parashiheshin përgjegjësitë e Ministrisë së Financave pa konsultim e miratim paraprak nga vetë përfaqësuesit e saj, kuptohet që një politikë e këtillë në drejtim të hartimit të Kontratës Kolektive, pa përllogaritje financiare, nuk është në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, me bazë në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këtu duhet shtuar edhe faktin që, në bazë të nenit 90 par.6 të Ligjit të Punës: "*Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tillë që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës se ato të përcaktuara me ligj*". Një dispozitë e këtillë është në pajtim edhe me nenin 4 të Ligjit të Punës të paraqitur më lart. Për këtë, mungesa e buxhetimit të Kontratës Kolektive, shpie pashmangshëm deri te pamundësia e realizimit të të drejtave të parapara, të cilat mund të parashohin kushte më të favorshme sesa ato të parapara në Ligjin e Punës. Një gjë e tillë është edhe në pajtim me obligimin e politikave qeveritare të kalojnë nëpër filtrin e Ministrisë së Financave, siç paraqitet edhe më poshtë. Andaj, edhe në rast të konkludimit të një marrëveshjeje të ligjshme, mungesa e buxhetimit do shpiente drejt pamundësimit të realizimit të politikës së paraparë me Kontratë.

Po ashtu, i duhet referuar edhe nenit 90 të Ligjit të Punës që flet për marrëveshjet kolektive dhe që në paragrafin 8 parasheh që: "*Marrëveshja kolektive regjistrohet në Ministri, në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me aktin nënligjor*". Në bazë të kësaj konkludohet lehtë që, përvçe që Kontrata Kolektive nuk i referohet Ligjit të Punës

me të cilin duhet të jetë në pajtueshmëri, nuk është as e regjistruar në Ministrinë përkatëse (Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve), sipas obligimit të paraparë me Ligj.

Në dritë të paragrafit paraprak i duhet referuar Udhëzimit Administrativ Nr.12/2011 të dikur Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të plotësuar/ndryshuar me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2020 (këtu e tutje referuar si: Udhëzimi Administrativ). Ky i fundit në mënyrë specifike parasheh procedurën e regjistrimit dhe shqyrtimin e marrëveshjeve (kontratave) kolektive. Pjesa më e rëndësishme është par.5 i nenit 4 ku theksohet që: *"Organi përgjegjës, nëse vlerëson se marrëveshja kolektive nuk është në kundërshtim me standardet minimale të Ligjit të Punës dhe legjisacionit tjetër përkatës, nxerr vendim për regjistrimin e marrëveshjes kolektive"*. Nga kjo dispozitë bëhet e kuptueshme që, Kontrata Kolektive duhet kaluar vlerësimin nga depàrtamentet përkatëse brenda Ministrisë të cilat, vetëm atëherë kur konstatojnë që nuk ka shkelje dhe që Kontrata është në pajtim me legjisacionin në fuqi, nxjerrin vendim për regjistrimin e saj. Në rastin konkret, Kontrata Kolektive nuk ka respektuar detyrimin e paraparë me ligj për regjistrimin e saj, e për këtë, nuk ka arritur as të kalojë filterin e pajtueshmërisë me ligjin me të cilin janë ngarkuar organet e Ministrisë përkatëse (tani të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve).

Së fundmi, por jo nga rëndësia, një Kontratë Kolektive e ligjshmë duhet të parasheh edhe mënyrën e zgjidhjes së kontesteve. Kontrata në fjalë, në nenin 41 i referohet zgjidhjes së kontesteve me dialog social apo: "përmes komisionit të pajtimit dhe të arbitrazhit". Përderisa nuk ka informacione shtesë rrith përbërjes apo funksionimit të komisionit të pajtimit dhe të arbitrazhit, bëhet e pamundur të kuptohet mënyra e zgjidhjes së kontestit. Për më tepër, arbitrazhi, si mjet për zgjidhjen e kontesteve, nuk i referohet kontesteve të punës në asnjë formë. Kontestet e vetme të cilat mund të zgjidhen përmes arbitrazhit janë kontestet ndërmjet bizneseve, të natyrës komerciale. Për më tepër, edhe sikur arbitrazhi të ishte i mundshëm, bëhet e pamundur zgjidha përmes komisionit të pajtimit dhe arbitrazhit pra një mjeti të vetëm që ngërthen, sipas interpretimit të thjeshtë - pajtim dhe arbitrazh, të cilat në asnjë formë nuk mund të përpushten apo të shkojnë njëra me tjetrën. Në këtë rast, me praninë e një klauzole të këtillë "patologjike" mënyra e shkëputjes së njëanshme bëhet e pashmangshme.

Për këtë, e bazuar në gjithë atë që u tha më lart, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit shkëput njëanshëm Kontratën Kolektive me SBASHK të datës 21 janar 2022. Për diskutime mbi Kontratën e re Kolektive në Arsim, ju ftoj që të takohemi dhe kërkosat e sindikatës ti trajtojmë, bazuar në kompetencat dhe të drejtat që burojnë nga ligji.

Me respekt,

